



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës Fehmi Kupina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 29.03.2022 Nr. 020-270
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim Nr. 01-020/01-62792/22 i datës 18.03.2022 i Kuvendit të Komunës së Prishtinës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 24.03.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr. 01-020/01-62792/22, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Vendimin Nr. Nr. 01-020/01-62792/22, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), *është në pajtim* me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 18.03.2022, ka miratuar Vendimin Nr. 01-020/01-62792/22, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për policinë, në nenet 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012MAPL për këshillat komunal për siguri në bashkësi. Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës me datë 18.03.2022, me 28 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenim, themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) me qëllim të krijimit të një organi këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve të komunës dhe përfaqësues të shoqërisë civile..

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. 020-270/7
Data. Datum. 08.04.2022

Za :	Përparim Rama, gradonačelnik opštine Prištine Fehmi Kupina, predsedavajuća Skupštine opštine Priština	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datum: 29.03.2022 br. 020-270
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:		
Predmet:	Razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine	
Vrsta akta:	Odluka br. 01-020/01-62792/22 od 18.03.2022.godine Skupštine opštine Priština	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenidopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je od 24.03.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Odluku br. 01-020/01-62792/22, o osnivanju Opštinskog saveta za bezbednost u zajednici (OSBB), usvojen u ime Skupštine opštine Priština.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) je razmotrilo zakonitost dotičnog akta, i:

POTVRĐUJE

Odluka br. 01-020/01-62792/22, o osnivanju Opštinskog saveta za bezbednost u zajednici (OSBB), *je u skladu* sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Priština na sednici održanoj datuma, 18.03.2022. godine, usvojila je Odluku br. 01-020/01-62792/22, o osnivanju Opštinskog saveta za bezbednost u zajednici (OSBB).

MALS, konstatuje da je usvojena odluka, od strane Skupštine opštine Priština zasnovana na članu 12. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi, sa članom 7 Zakona br. 04/L-076 o policiji, u članovima 3 i 4 Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP - 03 / 2012 MALS o opštinskim savetima za bezbednost zajednice. Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Priština datuma, 18.03.2022. godine, sa 28 glasova za, 0 protiv i 2 uzdržana, osnivanjem Opštinskog saveta za bezbednost zajednice (OSBB) radi formiranja savetodavnog tela za bezbednost zajednice uz široku zastupljenost svih zajednica u opštini i predstavnika civilnog društva.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.